



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SOKOL SH. MALAJ
ADRESA NR.2, LUIGJ GURAKUQI
TEL: 684055554

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1657

Nr. koleksioni: 654

Tirane më 06/10/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2020050710058640173



KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI
(TË SHOQËRISË "FROZER" SH.P.K)

Sot, më datë 06 Tetor 2020 (dy mijë e njëzet), ditën e marte, para meje Noter SOKOL SH. MALAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.2, LUIGJ GURAKUQI, u paraqitën personalisht:

PALA SHITËSE:

Znj. INA POREÇI, e bija e Sotiraq, dhe Alma, shtetase Shqiptare, lindur në Korçë më 14/05/1990 dhe banuese në KORÇË, me adresë NAZMI KABA 02330202; Nd. 11; H. 1; ; KORÇË; KORÇË; 7003; KORÇË, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033647890 dhe nr. personal J05514084I .—

PALA BLERESE:

Z. GENTJAN HAKA i biri i Jonus, dhe Xhumaje, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë më 14/02/1983 dhe banues në Tiranë, me adresë Hasan Vogli Pall 10/1/; Nd. 12; ; ; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia bashkiake nr. 2; 0000; Tiranë, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID #036368941# me Nr personal #I302141600#, aktualisht përdorues i telefonit 00355684000483.—

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "FROZER" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

NENI 1
PËRSHKRIMI I OBJEKTIT

Shitësja **Znj. INA POREÇI** është ortakë në kuotën prej 40% të kapitalit në Shoqërinë "FROZER" shpk e regjistruar si person juridik pranë QKB më datë 29.04.2020 me Nr unik të identifikimit të subjektit NIPT- **M01629004C**, e cila ndodhet me seli në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr 2, Rr"Luigj Gurakuqi", Pallati Mig-Mar, Pallati 12 katësh, Kati 1, Nr Pasurie 2/144-N2.—

Pala shitëse **Znj. INA POREÇI**, sipas marrëveshjes së arritur dhe me ortakun tjetër të shoqërisë, me vullnetin e saj të lirë e të plotë i shprehur me **Vendimin** Nr—1, të datës 30.09.2020 të Ortakëve të



Shoqërisë “FROZER” shpk, ka vendosur –shitjen me Akt Noterial të kuotës së saj prej 40% të kapitalit që ajo zotëron në këtë shoqëri — në favor të **Z. GENTJAN HAKA**.—

NENI 2

ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGESËS

Në bazë të marrëveshjes së arritur mes palëve jashtë kësaj zyre, shitësja **Znj. INA POREÇI** deklaron se është dakord që kuotën e saj të kapitalit prej 40% që ai zotëron në shoqërinë “FROZER” shpk, t’ia shesë blerësit **Z. GENTJAN HAKA** në vlerën **40.000 Lekë (dyzet mijë)**.—

Pala Blerëse deklaron se përpara nënshkrimit të këtij akti noterial ka likujduar jashtë kësaj tyre noteriale me para në dorë (CASH) vlerën prej **40.000 Lekë (dyzet mijë)**.—

Edhe Blerësi **Z. GENTJAN HAKA** deklaron se pranon të blejë këtë kuotë të kapitalit në shoqërinë e mësipërme në çmimin që ata kanë caktuar në marrëveshje të përbashkët, shumë kjo që i është likujduar plotësisht palës shitëse jashtë kësaj zyre noteriale me para në dorë (CASH).—

Veç sa më sipër, Blerësi deklaron se është dakord që të blejë këtë shoqëri me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ajo ka. Blerësi deklaron se është në dijeni të plotë të gjendjes aktuale financiare të kësaj shoqërie, se ka kontrolluar librat e kontabilitetit dhe se nuk ka asnjë pretendim apo mosmarrëveshje.—

Me likuidimin e plotë të vlerës së shitjes, pra të çmimit prej **40.000 Lekë (dyzet mijë)** shitësja **Znj. INA POREÇI** e humbet të drejtën e pronësisë e për rrjedhojë të cilësisë së Ortakes në shoqërinë tregëtare “FROZER” shpk, ndërsa Blerësi **Z. GENTJAN HAKA** fiton pronësinë në kuotën 40% duke u bërë kështu Ortak i shoqërisë.—

Pra, me hartimin dhe nënshkrimin e këtij Akti Noterial, shitësja **Znj. INA POREÇI** e humbet të drejtën e ortakërisë në këtë shoqëri dhe Ortak i kësaj Shoqërie, në kuotën 40%, bëhet blerësi **Z. GENTJAN HAKA**.—

Blerësi është i detyruar të paraqesë pranë **Q. K. B.** Vendimin e Ortakëve dhe aktin noterial të shitjes së kuotave në favor të ortakut **Z. GENTJAN HAKA**.—

NENI 3

BAZA LIGJORE

- 3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- 3.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
- 3.3 Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.

NENI 4

ANEKSET E KONTRATËS

9.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Anekse të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë i Ortakëve me nr. 1, datë 30.09.2020, bashkëlidhur vërtetim nënshkrimi.
- Ekstrakt i Regjistrisë Tregtare për Shoqërinë “FROZER” Sh.p.k. datë 30.09.2020;
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.



NENI 5
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

13.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

13.2 Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

13.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËTKONTRAKTUESE

PALA SHITËSE:

Znj. INA POREÇI

Ina Poreci

[Signature]

PALA BLERËSE:

Z. GENTJAN HAKA

Z. Gentjan Haka

NOTER

SOKOL SH. MALAJ



**AKSA E PULLES
U PAGUA**

NOTER. SOKOL SH. MALAJ

RR "LUIGJ GURAKUQI" P 2 TIRANË, ALBANIA

Tel: +355 4 222 98 32 / Cel: +355 68 40 5555 4

e-mail: kolimalaj@hotmail.de

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-20201002112042754
Data e Rezultatit te Kerkimit: 02.10.2020
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 11:20:42AM
Lloji i Kerkimit: MALLRA ME NUMER SERIE
Numri i Dokumentit: D-400-654-749
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E MALLRAVE ME NUMER SERIE ME REZULTAT KERKIMI 0

M01629004C



Fundi i Rezultatit te Kerkimit:
Fundi i Dokumentit

Ado G...